



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 24.10.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Të tjera - Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarës {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 08:38 dhe mbaroi në orën 09:23.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje zoti ***Medi Bici***, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
2. **Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
3. **Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
4. **Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.**
5. **Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
6. **Klodian Rado, EURALIUS.**
7. **Valbona Paja, USAID.**

RENDI I DITËS:

2. Të tjera – Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtares {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës e cila bën fjalë për shqyrtimin e projektvendimit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtares {...}, për shkak të dorëheqjes nga detyra.

Lidhur me relativimin e këtij projekt-akti, fjalën ia jap zotit Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 23.10.2019, është depozituar një kërkesë me shkrim (protokolluar me nr.5044) nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. {...}, njëkohësisht dhe kryetare, nëpërmjet të cilës ajo ka parashtruar dorëheqjen e saj nga statusi i magjistratit.

Ky institut rregullohet nga neni 65 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe përcakton si më poshtë: “Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr

deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Në rastin konkret, dorëheqja e znj. {...} është bazuar në pikën 3, të nenit 65, të ligjit të Statusit.

Si motiv të dorëheqjes znj. {...} ka parashtruar angazhimin e saj në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor, konkretisht në pozicionin e Drejtueses së Drejtorisë Juridike pranë Spitalit Amerikan, pozicion pune që i ishte ofruar më datë 23.10.2019, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së punës me Institutin e Shëndetit Publik të sipërcituar, efekte që në bazë të kontratës fillojnë më datë 01.11.2019. Ndërkohë kur dorëheqja, sipas nenit 65 të ligjit të sipërcituar, jep efekte në fund të muajit pasardhës nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes, domethënë më datë 30.11.2019.

Për rrjedhojë, znj. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien efekt të saj përpara datës 01.11.2019, ditë kur ajo duhet të fillojë punë pranë Shoqërisë “American Hospital” sh.a.

Ne lidhje me moscenimin e interesit publik nga dhënia efekte të dorëheqjes përpara afatit ligjor, konstatohet se me cilësinë e kryetares së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. {...} ka ngarkesë të çështjeve gjyqësore të reduktuar dhe konkretisht 23 nga të cilat asnjë nuk kërkon shqyrtim të ngutshëm. Në konsideratë të kësaj ngarkese rezulton se largimi nga puna për shkak të dorëheqjes së magjistratit nuk do të sillte ndikim në ngarkesën e çështjeve gjyqësore tek gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate si edhe nuk krijon situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë.

Nga sa më sipër, rezulton që në rastin konkret të plotësohen kërkesat e ligjit për miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të dorëheqjes së gjyqtares znj. {...}, duke i dhënë asaj efekte përpara kohës së përcaktuar nga ligji, pika 2, e nenit 65, të ligjit të Statusit. Së pari, pranë Këshillit është depozituar me shkrim kërkesa për heqjen dorë nga statusi i magjistratit. Së dyti, kjo kërkesë është e motivuar, pra gjyqtarja në fjalë ka parashtruar

një motiv për dorëheqjen e saj, motiv ky që, përveç se personal, nuk mund të vlerësohet si i pajustificuar. Së treti, dhënia efekte të dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar nga ligji, nuk cenon interesin publik në kuptimin e krijimit të ndonjë situatë negative të pakthyeshme për dhënien e drejtësisë, e cila në çdo rast duhet të mbahet në vëmendjen e Këshillit, si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Sa i përket kohës kur dorëheqja e gjyqtares znj. {...} duhet të japë efektet, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të duhet të konsiderojë kërkesën e gjyqtares nga njëra anë, por edhe lënien e një kohë të mjaftueshme brenda të cilës gjyqtarja mund të përfundojë gjykimin e atyre çështjeve që mund të jenë në fazën e fundit, por edhe për dorëzimin e detyrës nga ajo. Nga vlerësimi mbi këto kritere, data 31.10.2019 duket që konsideron të dyja ato.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e znj. {...}, kryetare, njëkohësisht dhe gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të vendosë: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.10.2019. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Në këtë aspekt është propozuar edhe projektvendimi përkatës, në dispozitivin e të cilit përcaktohet se: Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.10.2019. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve

nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim për projekt-aktin, përpara se ta hedhim në votim?

Brikena Ukperaj: Diçka në lidhje me dispozitivin.

Kemi pikën 2 dhe pikën 4 që në thelb përmbajnë disponime të ndryshme, por që vetëm e nënkuptuar mund të rezultojë që pika 2 lidhet me pikën 1 dhe pika 4 me pikën 3. Pra edhe 2-shi edhe 4-a, thonë: 2) Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më 31.10. dhe, 4) Efektet e këtij urdhërimi fillojnë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Unë e kuptoj. Ideja është që ndoshta duhej më saktë, apo mendoni që është e kuptueshme?

Erjon Muharremaj: Pra pika 2 thotë “efektet e pikës 1” dhe...

Brikena Ukperaj: Nuk ka nevojë fare të themi 4-ën sepse thuhet “ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare” dhe nënkupton që pika 3 do hyjë në fuqi menjëherë. Pika 4 mund të hiqet fare. Mund të themi: “Përrjashtimin e menjëhershëm nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short”, dhe heqim fare pikën 4. “Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtarës {...} nga procedurat e ndarjes... me short”, dhe pika 4 bie.

Brunilda Kadi: “Të përjashtojë gjyqtaren menjëherë nga procedurat e ndarjes me short”, dhe të hiqet pika 4.

Erjon Muharremaj: Atëherë, të hidhet në votim propozimi i zonjës Ukperaj.

Naureda Llagami: Atëherë, jemi dakord që pika 3 të ndryshohet, duke thënë: “Të përjashtohet menjëherë, gjyqtaren zonja {...} nga procedura e ndarjes me short të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor...”, dhe pika 4 të hiqet. Kalojmë pastaj, numërimi i projekt-aktit do jetë 1, 2, 3, 4, 5. Jemi dakord me propozimin e bërë?

Atëherë, ta hedhim projekt-aktin në votim, me gjithë propozimin e bërë nga zonja Ukperaj?

Dakord! E hedhim në votim projekt-aktin.

(Anëtarët e Këshillit flasin pa ndezur mikrofonat.)

Maksim Qoku: Kundër, për faktin që unë nuk e çmoj që shkak është urgjent apo i nevojshëm që ne të aplikojmë rastin e përjashtimit të nenit 65, kështu që, nisur nga fakti që rregulli vë një afat të muajit pasardhës, do desha që Këshilli të ishte i përgjegjshëm në lidhje me çmuarjen e situatës së emergjencave dhe natyrës së vlefshmërisë së tyre. Për më tepër, do jap edhe mendimin kundër në protokoll. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të dorëheqjes së motivuar të saj nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.10.2019. 3. Të përjashtohet menjëherë gjyqtarja znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. 4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim tjetër, mbledhjen e sotshme e konsideroj të mbyllur.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Mirupafshim!

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)